



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1154 / 13 Prot.

Vlorë më, 15 08 2022

VENDIM

Nr. 29, datë 15.08.2022

PËR  
MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË OFRUARA NGA QENDRA RDC

Mbështetur në nenin 3, pika 3, gërma a të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe referuar propozimit të Drejtorit të Qendrës së Zhvillimit Rajonal nr.955 prot, datë 06.07.2022 të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në mbledhjen e datës 15.08.2022 Bordi i Administrimit

VENDOSI

1. Të miratojë tarifat e shërbimeve të ofruara nga Qendra RDC, në masën 1200 lekë për kredit, për modulet e reja të aplikuara dhe të akredituara, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të bëhet pagesa e fashës 7, për ofrimin e shërbimeve për portalin e trajnimeve bazuar në udhëzimin e MAS nr.16, datë 28.07.2021, kreu II, neni 8.
3. Të miratojë ndarjen e të ardhurave të përfituara nga trajnimet, miratuar me Vendim BA nr.3, datë 12.01.2021 në masën 70% të të ardhurave për trajnues dhe 30% për institucionin.
4. Vlera 30% e të ardhurave për institucionin të përdoret për të paguar tarifën 500 euro në vit, si dhe për shpenzime operative dhe investime në qendër.
5. Ngarkohen për zbatim të këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
6. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Qendrës RDC në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
Sotir NIKOLLA



Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288

web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)

KODI PËR MODUL	TEMAT E MODULEVE QË KALOJNË	NR. I ORËVE TË MODULIT	NR. I KREDITEVE TË MODULIT	LLOJI I TRAJNIMIT
22EKP071	INTEGRIMI I EDUKIMIT SIPËRMARRËS NË KURRIKULAT MËSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR	18	1	TRAJNIM I DREJTËPËRDREJTË
22GJ060	METODA DHE STRATEGJI ME MBËSHTETJE TË NXËNËSVE ME AFTËSI NDRYSHE	18	1	TRAJNIM I DREJTËPËRDREJTË
22EKP072	ZHVILLIMI I DISA AFTËSIVE BAZË KRIJUESE MUZIKORE DHE ARTISTIKE PËR MËSUESIT E ARSIMIT FILLOR	18	1	TRAJNIM I DREJTËPËRDREJTË
22EKP073	ROLI KRIJUES DHE INOVATIV I MËSUESIT NBË ZHVILLIMIN DHE ZGJEDHJEN E MODELEVE JETËSORE, ILUSTRUESE PËR NJË MËSIMNXËNIE EFEKTIVE	18	1	TRAJNIM I DREJTËPËRDREJTË

